Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**26.10.2023**	**27.10.2023**	**2023/0796**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.10.2023, **OE "DIAMANTI SH.P.K."- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0796**, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit ne fshatin Vrelle te Magures dhe Gypi furnizues Gllavice - Babush"** me nr. të prokurimit: **"613-23-9106-5-2-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **135,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56.3 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

Të nderuar, ju njoftojmë se me dt: 28.09.2023 kemi pranuar Letren standarte kerkese per sqarime shtese per mekanizem me arsyetimin qe librezat nuk shihen mire, pase sqarimit nga DIAMANTI SHPK ne vend qe te rekomandohemi per kontrate kemi pranuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me dt. 05.10.2023, me arsyetimin se "*një ngjarje e paparashikuar ka ndodhur tek pershkrimi i qmimeve dhe nuk mund te evitohet tani ne fazen e vlersimit'', ky vendim* është bërë pikërisht që ne mos te shpallemi fitues të kësaj kontrate, ky fakt se ne duhet të jemi fitues të kësaj kontrate është kuptuar edhe nga ana AK-së, sepse po te kishte ngjarje te pa parashikuar te pershkrimi qmimeve nuk do te kerkonte sqarime shtese.
Pasi që autoriteti kontraktues e ka parë që duhet ta shpall fitues OE Diamanti pase sqarimit te letres standarte, arsyet e AK-së janë vetëm pretekste dhe tendencë për të na eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit, gjë qe është bërë pa asnjë bazë ligjore, per arsye se:

a) Per pozicionet 2.1 ne Vrelle dhe Babush te Lipjanit eshte vendosur sasia totale e gypave ne paramase pa njesi dhe nuk ka te beje me asnje leshim ne paramase sepse nuk ka qmime te vendosuara nga asnje OE, gjithashtu pozicoini 4.2.4 eshte shume i kjart sepse sasia ne pozicion nuk tregon vendosjen e qmimit por nenpozicionet tregojn sasine per vendosjen e çmimeve, prandaj vetem OE qe nuk jan perfosional ne kete veprimtari e kane te pa kjart kete pozicion.

b) OE qe ka vendosur çmim ne kete pozicion duhet te shpallet i pa pergjegjshem e jo te anulohet aktivitetin e prokurimit ne kete faze sepse pozicioni 4.2.4 eshte pozicion per nje puset komplet pra vetem nyja nr. 4 dhe jo pjeset qe do te montohen ne puset

c) OE DIAMANTI SHPK dhe Infra Plus jane OE te pergjegjshem per arsye se nuk kan vendosur çmime ne pozicion 4.2.4 me qka kane tregu profesinalitet te lart.

d) Paramasa dhe parallogaria ka qene e barabarte per te gjitha kompanite oferutese,dhe pozicioni 4.2.4 ku ka vendour qmim OE i tret ne radhe që i njëjti është i papërgjegjshëm nuk e ndikon ne ndryshim ofertes financiare, ku kuptohet qe OE mund te trajtohen ne menyre te barabarte.

e) Kompania jone duhet te rekomandohet per kontrate sepse kemi ofertuar me çmim më të ulët se sa kompanitë tjera të përgjegjshme.

Në këtë fazë AK-ja ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, me asnjë dispozitë ligjore të LPP-së, nuk lejohet të ndërmerret një veprim i tillë me një arsyetim të tillë, mirëpo ka vepruar në mënyrë arbitrare. Neni 62 i LPP-së nuk e parasheh dhe nuk e lejon që një aktivitet i prokurimit të anulohet pas hapjes së ofertave me arsyen që AK-ja ka anuluar, sepse kjo arsye nëse do të ekzistonte do të merrej parasysh para fillimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.
Gjithashtu ky anulim është në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast, dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

AK-ja në sqarimin që e keni bërë tek njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i jeni referuar Rregullave për Prokurim Publik, mirëpo nuk e ka cekur asnjë dispozitë të këtij Ligji, prandaj arsyeja e anulimit është e pabazuar dhe e paqëndrueshme por ky anulim është bërë me qëllim të diskriminimit të kompanisë tonë e cila i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht kemi ofertuar me çmim më të ulët se sa kompanitë tjera të përgjegjshme. Pra këtë veprim të AK-së nuk mund ta marrim ndryshe përveç se tendencë për të na eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit, edhe përkundër faktit që jemi OE i përgjegjshëm me çmim me te lire.

Në lidhje me këtë çështje nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë për rishqyrtim e as një ankesë gjatë fazës së tenderimit, e ku një aktivitet i prokurimit mund të anulohet për kërkesa, specifika apo ndonjë lëshimi në paramasë, kurse edhe ju si AK në momentin e inicimit dhe publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit keni qenë po këta zyrtarë dhe keni pas po këto njohuri që i keni tani dhe me vetëdije të plotë e keni shpallur dhe përgatitur paramasën në këtë mënyrë dhe nëse eventualisht do të kishte ndonjë lëshim atëherë ju do ta kishit vërejtur gjatë fazës së ka qenë i shpallur tenderi, e jo këtë çështje ta theksoni se gjoja e keni kuptuar në momentin pas hapjes së ofertave, e kur janë zbuluar çmimet dhe normalisht kur kuptohet fituesi i këtij tenderi.

Me kete vendim per anulim te këtij aktiviteti të prokurimit qe është bere nga AK-ja neve si OE per here dyte po na bahet e padrejte nga AK-ja Komuna Lipjan duke perfshire edhe aktivitetin e prokurimit ujesjellesin e vitit 2022, duke pasur parasyshe se e kemi fituar me OSHP.

Të nderuar kërkojmë nga ju që të zbatoni procedurat dhe dispozitat e LPP-së, sepse jeni të thirrur ta bëni këtë gjë dhe mos vazhdoni të na diskriminoni dhe të na dëmtoni sepse këtë e ndalon neni 7 i LPP-së, për shkak se ne jemi fitues potencial të kësaj kontrate dhe për të ardhur deri këtu kemi bërë një punë, angazhim dhe mund të madh, dhe kemi bërë shpenzime materiale dhe ne nuk duhet të pësojmë për shkak të subjektivizmit në këtë aktivitet ë prokurimit.

Poashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

Gjithashtu pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, ju njoftojmë se këtë tender me këtë vendim ne e konsiderojmë tender **të kurdisur** dhe normalisht që nëse nuk mirret parasysh kërkesa për rishqyrtim do të jemi të (shtrenguar)detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera të cilat i përkasin fushës penale,(organet perkatse ekonomike).

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni kërkesën për rishqyrtim dhe të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "**Diamanti SH.P.K**"- Prishtinë
ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**.
DETYROHET AK-ja që rivlerësimin e ofertave ta bëjë sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform **kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë,** sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

			Gjithsejt me TVSH:		0.00
2	**Punimet tokësore**				
2.1	Gërmimi i dheut të kateg III-IV me makinë dhe dorë, me gjerësi mesatare dhe thellësi mesatare nga kuota e niveletës, varësisht nga diametrat e gypave: Për gypat: OD 110, b=0.50m dhe h=1.0m; OD 90, b=0.50m dhe h=1.0m; OD 75, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 63, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 50, b=0.40m dhe h=1.0m;		3,090.00		
2.1.1	-Me makinë 90 %	m³	1,390.50		
2.1.2	-Me dorë 10 %	m³	154.50		
	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktesi ±1cm.	m²	154.50		
2.2	Furnizimi dhe vendosja e rërës me fraksion 0-16mm nën,mbi dhe anash gypit me planifikim dhe ngjeshje çdo 20-30 cm vetem ne vende ku eshte e nevoshme.	m³	540.75		
2.3	Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar në shtresa çdo 20-30 cm me ngjeshje 40 Mpa	m³	754.25		
2.4	Furnizimi dhe instalimi i shiritit detektues me fije teli mbi gypin e instaluar: Shiriti duhet të lidhet me pjesët e shkeputara (vazhduese-me lidhese-kllapë) dhe me pjesët fazonike si dhe gjithashtu duhet të bëhet edhe testimi i detektimit para mbulimit të kanali dhe në prani të organit mbikqyres.	m'	3,090.00		
2.5	Matja gjeodezike e elementeve të rrjetit si dhe matja e gypit para mbulimit të kanalit në çdo thyerje horizontale, vertikale dhe ne pikat e saldimit (për gypa >40mm), të dhenat e matjeve duhet te pergaditen ne formatin DWG dhe EXCEL dhe te dorezohen në raporte javore tek KRUP-DPZH.	m'	3,090.00		
2.6	Mbulimi i kanalit me zhavor (31.5mm) të përpunuar deri në nivelin e asfaltit,betonit dhe kubëzave në shtresë çdo 20-30 cm me ngjeshje 80 Mpa, vetem ne vendet ku eshte e nevojshme.	m³	250.00		
2.7	Largimi i dheut të tepërt në deponinë legale per hudhjen e materialeve	m³	700.75		

	si dhe data e mbarimit te punimeve.				
			Gjithsejt me TVSH:		
2	**Punimet tokësore**				
2.1	Gërmimi i dheut të kateg III-IV me makinë dhe dorë, me gjerësi mesatare dhe thellësi mesatare nga kuota e niveletës, varësisht nga diametrat e gypave: Për gypat: OD 110, b=0.50m dhe h=1.0m; OD 90, b=0.50m dhe h=1.0m; OD 75, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 63, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 50, b=0.40m dhe h=1.0m;		3,098.00		

4.2.2.7	Njëmates Zonal Woltman DN 100mm PN 16	copë	1.0		
4.2.3	**Nyja (N-3) Puseta Shkarkuese**				
4.2.3.1	T DN 100/50, PN 16	copë	1.0		
4.2.3.2	Adapter Flansh për PE OD - 110mm PN 16	copë	2.0		
4.2.3.3	Adapter Flansh për PE OD - 63mm PN 16	copë	1.0		
4.2.3.4	Valvulë me teleskop DN - 50 mm PN 16	copë	1.0		
4.2.3.5	Kthesë 90 DN - 50 mm PN 16	copë	1.0		
4.2.3.6	Fazon FF DN-100/600 mm PN 16	copë	2.0		
4.2.3.7	Fazon FF DN-50/600 mm PN 16	copë	1.0		
4.2.4	**Nyja (N-4) Puseta e ajrit**	copë	1.0		
4.2.4.1	T DN 100/50, PN 16	copë	1.0		
4.2.4.2	Adapter Flansh për PE OD - 110mm PN 16	copë	2.0		
4.2.4.3	Valvulë me teleskop DN - 50 mm PN 16	copë	1.0		
4.2.4.4	Fazon FF DN-100/600 mm	copë	2.0		
4.2.4.5	Valvulë e ajrit DN 50mm	copë	1.0		
4.2.5	**Nyja (N-5)**				
4.2.5.1	T DN 100/50,PN 16	copë	1.0		
4.2.5.2	Adapter Flansh për PE OD - 110mm, PN 16	copë	2.0		
4.2.5.3	Valvulë me teleskop DN - 50 mm ,PN 16	copë	1.0		
4.2.5.4	Adapter Flansh për PE OD - 63mm ,PN 16	copë	1.0		
4.2.6	**Nyja (Nyja 6)**				
4.2.6.1	Adapter Flansh për PE OD - 110mm PN 10	60.00	2.0		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komuna Lipjan

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: "**Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë - Babush**" Numri i aktivitetit te prokurimit: **613-23-9106-5-2-1**

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës €
1.	DIAMANTI SH.P.K. Rr.Naim Frasheri nr.16, Prishtinë	**127,957.30**
2.	" Infra-Plus " SH.P.K. Rr.Luan Haradinaj Sol.1 H.1, Prishtinë	**132,907.35**
	N.N.P. Wenda F.SH. DOLAK, VUSHTRRI	**134,748.70**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
[*zgjedh njërin opsion*]

Komuna Lipjan anulon këtë aktivitetet të prokurimit për arsyes se të përshkrimi i çmimeve përkatesisht te Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në Vrellë- Lipjan te punët tokesore të pozicioni 2 pika 2.1 është vendosur gabimisht sasia nga ana e AK-se, po ashtu te Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në Babush- Lipjan të punët tokesore të pozicioni 2 pika 2.1 eshte vendosur gabimisht sasia nga ana e AK-së, si dhe të punët montuese të pozicioni 4, nenpozicioni 4.2 pika 4.2.4 eshte vendosur gabimisht njesia dhe sasia nga ana e AK-se, ku me kete rast disa operator ekonomik i kane plotesuar keto pozicione e disa operator ekonomik nuk i kane plotesuar keto pozicione. Korrigjimi ne kete faze i këtyre pozicioneve eshte i pamundur dhe ne pamundesi per te vleresuar konformë nenit 59 LPP-së dhe per ti trajtuar OE te barabarte konforme nenit 7 te LPP-se ne si komision i vleresimit rekomandojme qe kjo procedure te anulohet me arsyetimin se nje ngjarje e paparashikuar ka ndodhur dhe nuk mund te evitohet tani në fazen e vlerësimit.

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni vlerësues rekomandon drejtorin e prokurimit për anulimin e këtij aktivitetit të prokurimit për arsyes se të përshkrimi i çmimeve përkatesisht te Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në Vrellë- Lipjan te punët tokesore të pozicioni 2 pika 2.1 është vendosur gabimisht sasia nga ana e AK-se, po ashtu te Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në Babush- Lipjan të punët tokesore të pozicioni 2 pika 2.1 eshte vendosur gabimisht sasia nga ana e AK-së, si dhe të punët montuese të pozicioni 4, nenpozicioni 4.2 pika 4.2.4 eshte vendosur gabimisht njesia dhe sasia nga ana e AK-se, ku me kete rast disa operator ekonomik i kane plotesuar keto pozicione e disa operator ekonomik nuk i kane plotesuar keto pozicione. Korrigjimi ne kete faze i këtyre pozicioneve eshte i pamundur dhe ne pamundesi per te vleresuar konformë nenit 59 LPP-së dhe per ti trajtuar OE te barabarte konforme nenit 7 te LPP-se ne si komision i vleresimit rekomandojme qe kjo procedure te anulohet me arsyetimin se nje ngjarje e paparashikuar ka ndodhur dhe nuk mund te evitohet tani në fazen e vlerësimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DIAMANTI SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit me titull **"Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë – Babush"**me nr. të prokurimit **613-23-9106-5-2-1** inicuar nga AK- Kuvendi Komunal Lipjan, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 30.08.2023, me procedurë të hapur, lloji i kontratës punë, hapja e ofertave është bërë me datë 19.09.2023, si dhe vendimi i AK-së është publikuar me datë 05.10.2023.

AK aktivitetin e prokurimit në fjalë ka anuluar me arsyetimin se:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
[*zgjedh njërin opsion*]

Komuna Lipjan anulon këtë aktivitetet të prokurimit për arsyes se të përshkrimi i çmimeve përkatesisht te Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në Vrellë- Lipjan te punët tokesore të pozicioni 2 pika 2.1 është vendosur gabimisht sasia nga ana e AK-se, po ashtu te Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në Babush- Lipjan të punët tokesore të pozicioni 2 pika 2.1 eshte vendosur gabimisht sasia nga ana e AK-së, si dhe të punët montuese të pozicioni 4, nenpozicioni 4.2 pika 4.2.4 eshte vendosur gabimisht njesia dhe sasia nga ana e AK-se, ku me kete rast disa operator ekonomik i kane plotesuar keto pozicione e disa operator ekonomik nuk i kane plotesuar keto pozicione. Korrigjimi ne kete faze i këtyre pozicioneve eshte i pamundur dhe ne pamundesi per te vleresuar konformë nenit 59 LPP-së dhe per ti trajtuar OE te barabarte konforme nenit 7 te LPP-se ne si komision i vleresimit rekomandojme qe kjo procedure te anulohet me arsyetimin se nje ngjarje e paparashikuar ka ndodhur dhe nuk mund te evitohet tani në fazen e vlerësimit.

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me date 16.10.2023 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të ligjit përkatësisht nenin 1, 7, 56.3, 59, 60, 62, 69, 72 të LPP-së.

Pretendimi I OE ankuesit kundër AK-së-anulimit:

Në këtë fazë AK-ja ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, me asnjë dispozitë ligjore të LPP-së, nuk lejohet të ndërmerret një veprim i tillë me një arsyetim të tillë, mirëpo ka vepruar në mënyrë arbitrare. Neni 62 i LPP-së nuk e parasheh dhe nuk e lejon që një aktivitet i prokurimit të anulohet pas hapjes së ofertave me arsyen që AK-ja ka anuluar, sepse kjo arsye nëse do të ekzistonte do të merrej parasysh para fillimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.
Gjithashtu ky anulim është në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast, dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

AK-ja në sqarimin që e keni bërë tek njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i jeni referuar Rregullave për Prokurim Publik, mirëpo nuk e ka cekur asnjë dispozitë të këtij Ligji, prandaj arsyeja e anulimit është e pabazuar dhe e paqëndrueshme por ky anulim është bërë me qëllim të diskriminimit të kompanisë tonë e cila i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht kemi ofertuar me çmim më të ulët se sa kompanitë tjera të përgjegjshme. Pra këtë veprim të AK-së nuk mund ta marrim ndryshe përveç se tendencë për të na eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit, edhe përkundër faktit që jemi OE i përgjegjshëm me çmim me te lire.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në E-prokurim publikon paramasën lidhur me aktivitetin në fjalë, me date 19.09.2023 I njëjti hap ofertat, tutje gjatë vlerësimit AK me date 28.09.2023 kërkon sqarime nga OE ankuesi lidhur me kërkesat teknike /profesionale, ku OE ankuesi me date 29.09.2023 ka kthyer sqarimet, të cilat AK I merr të mirëqenë.

Pastaj, me date 05.10.2023 AK publikon vendimin mbi anulimin me arsyetimin se ka gabime në paramasë, e cila nuk mund të rregullohet në vlerësim.

Tutje ekspertja sqaron, në këtë aktivitet janë në proces tre operator ekonomik. Në ofertat e tyre janë të bashkangjitura paramasat, ku dy prej tyre kanë kuptuar paramasën dhe nuk kanë shprehur huti, ndërsa njëri operator ka vendosur çmim në hapsirën ku nuk duhet të vendoset, dhe si e tillë AK/komisioni i vlerësimit ka vërejtur që ky operator ka vendosur çmim në ato pozicione, andaj merr vendim që ta anuloj aktivitetin e prokurimit, me arsyetimin se nuk mund të rregullohet.

Më lartë është e bashkangjitur paramasa e AK-së tek kriteret për vlerësim (pozicionet e pretenduara):

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të paramasës së publikuar nga AK, duke e krahasuar me ofertat e operatorëve ekonomik sqaron se, në këtë aktivitet të prokurimit dy operator kanë kuptuar gabimin e AK-së në paramasë, kurse njëri ka vendosur në pozicionin 4.2.4 çmimin 49 euro, çka do të thot se dallimi në çmimin përfundimtar të ofertës së tij ndryshon për 49 euro, i cili konsideroj se nuk ndikon në vlerësimin përfundimtar të ofertave, po ashtu nuk ndikon në ndryshim të radhitjes së operatorëve ekonomik, dhe si e tillë konsideroj se arsyeja e anulimit nuk gjenë mbështetje ligjore sipas nenit 62 të LPP-së si dhe nenit 43.7 të rregullores për prokurim publik.

Si përfundim, ky aktivitet i prokurimit konsideroj se duhet të kthehet në rivlerësim, duke rekomanduar AK-në që procesin e rivlerësimit të zhvilloj konform dispozitave ligjore përkatësishtë nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40.9 të rregullorës për prokurim publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DIAMANTI SH.P.K.**

Blerina Huruglica